

NACIONALIZMI SHQIPTAR NË VITET 1912-1924

(Sali Kadria, *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*, botim i Institutit të Historisë - Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë, Tiranë: 2020, 680 f.)

Monografia e paraqitur para Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë nga dr. Sali Kadria, është një përpjekje serioze dhe e lavdërueshme, që ka si objekt studimi, ecurinë dhe zhvillimin e nacionalizmit shqiptar, si një nga shtyllat themelore dhe ekzistenciale të kombit shqiptar në vitet 1912-1924, e cila është një nga periudhat më të rëndësishme, por edhe ndër më të komplekset, pasi është e mbushur me një veprimtari të ngjeshur politike dhe me shumë ngjarje historike.

Që në fillim të paraqitjes sime, dëshiroj të theksoj se përzgjedhja e kësaj teme ka qenë sa e guximshme aq edhe e vlefshme, pasi është synuar që përmes analizës dhe një përjasjeje autentike të studiohej një fenomen kaq jetik historiografik, siç është nacionalizmi shqiptar. Siç dihet nga ne që merremi me kërkimin shkencor në fushën historike, në përgjithësi, për nacionalizmin shqiptar ka pak studime gjithëpërfshirëse dhe bazike, veçanërisht për nacionalizmin shqiptar në vitet e para të procesit tepër të vështirë të shtetformimit dhe forcimit të identitetit kombëtar.

Përveç studimeve bazike të studiuesve, si: Stavro Skëndi, Nathalie Clayer apo ndonjë autori tjetër, kryesisht të huaj, të cilët kanë trajtuar nacionalizmin shqiptar kryesisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare, ka një mungesë të dukshme studimesh të fokusuara te nacionalizmi shqiptar gjatë shekullit XX. Merita e autorit është se ka identifikuar me saktësi këtë boshllëk në historiografi rreth nacionalizmit shqiptar dhe ka marrë përsipër trajtimin e këtij fenomeni. Prandaj, mendojmë se tema është e gjetur dhe plotëson më mirë kuadrin e historisë së Shqipërisë dhe të shqiptarëve. Realizmi i kësaj monografie mendoj se ka qenë një proces i vështirë dhe kompleks, që e ka vënë autorin përballë sfidave madhore shkencore, të cilat ai ka arritur t'i kapërcejë me sukses.

Së pari, analiza e nacionalizmit shqiptar në vitet 1912-1924, kërkonte një përgatitje të përgjithshme teorike dhe njohuri të gjera mbi nacionalizmin modern si një fenomen dhe institucion themelor i shoqërive bashkëkohore. Autori ka shfrytëzuar dhe paraqitur në mënyrë kritike studimet më të rëndësishme të fushës teorike dhe historiografike kushtuar nacionalizmit në rrafsh botëror, evropian dhe posaçërisht të nacionalizmit ballkanik, pra të rajonit tonë.

Përballimi me sukses i kësaj detyre të vështirë, i ka dhënë autorit mundësinë që të ndërtonte me kujdes tezën e tij shkencore rreth nacionalizmit shqiptar. Hulumtimi dhe përvetësimi i thellë i arritjeve të shkencave politike, historike e sociale botërore mbi nacionalizmin, gjithashtu i ka dhënë autorit mundësinë e krijimit të një baze të shëndoshë konceptuale, gnoseologjike e metodologjike nga e cila do të fillonte analiza e gjithanshme e nacionalizmit shqiptar.

Analiza e mbështetur mbi këtë bazë të shëndetshme dhe solide shkencore, njëkohësisht dhe të avancuar, me theks modern, është një meritë e veçantë e këtij punimi shkencor.

Së dyti, autori ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat e gjithë literaturës historiografike mbi historinë e shqiptarëve gjatë tre dekadave të para të shek. XX, duke ndërtuar argumente të vlefshme si dhe nxjerrë prej saj përfundime të qëndrueshme e serioze lidhur me analizat e parashtruara rreth nacionalizmit shqiptar.

Së treti, autori ka bërë hulumtime të gjera mbi shumë burime e koleksione arkivore, ku spikasin burime nga fondet e institucioneve shtetërore, organizatave politike, personaliteteve të njohura të nacionalizmit shqiptar të kësaj periudhe, kujtime e refleksione të botuara dhe të pabotuara të tyre, si dhe analizat tepër të vlefshme e interesante të paraqitura në shtypin e kohës. Gjithashtu, vlen të theksohet se për realizimin e monografisë janë shfrytëzuar fondet e arkivave austro-hungareze, britanike, italiane e të tjera, të cilat kanë plotësuar më tej kuadrin e mendimit dhe kanë thelluar më tej analizat, veçanërisht ato të bëra nga diplomatë dhe institucione politike të huaja për nacionalizmin shqiptar. Pra, është plotësuar këndvështrimi i studiuesit për nacionalizmin shqiptar, me informacione të dorës së parë që vijnë së jashtmi, çka është një komponent shumë i rëndësishëm i studimit. Pas konsultave dhe tërheqjes së mendimeve të kolegëve të tij, autori ka arritur ta çojë nivelin e punimit aty ku duhet, prandaj mendoj se e ka justifikuar veten. Me këtë monografi, autori ia ka dalë me sukses të na japë një tablo të saktë e të gjerë të nacionalizmit

shqiptar përgjatë momenteve më të rëndësishme të tij, në vitet e para historike të procesit të shtetformimit.

- Autori ka treguar një qasje të përshtatshme nga pikëpamja metodologjike. Nacionalizmi është paraqitur në një mënyrë të gërshetuar tematiko-kronologjike, ku trajtimi fillon qysh para shpalljes së pavarësisë, vijon me përpjekjet e forcave nacionaliste për ndërtimin e shtetit shqiptar, të cilat u zhvilluan në bashkëpunim, por edhe nën ndikimin e influencave të Fuqive të Mëdha dhe të organizmave të huaja të krijuara nga këto fuqi vendimmarrëse. Kjo nxiti më tej copëzimin e nacionalizmit shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore, por që në përfundim të kësaj lufte, ai arriti të rikrijonte me forcat e tij shtetin shqiptar dhe institucionet kombëtare me veçoritë dhe prerogativat e tyre.
- Autori ka arritur të japë në mënyrë të balancuar, anët pozitive dhe të forta të nacionalizmit shqiptar ashtu edhe defektet historike të tij, duke sqaruar origjinën apo faktorët që kanë ndikuar në tiparet e tij. Në këto analiza të shumanshme, ai ka demonstruar pjekuri shkencore, gjykim të mprehtë dhe të balancuar, çka e bëjnë atë një studiues me të ardhme në fushën e kërkimit shkencor historiografik.
- Autori ka sjellë një informacion të pasur për nacionalizmin shqiptar të kësaj periudhe. Ai ka arritur të identifikojë dhe të dallojë grupet apo rrymat e ndryshme të mendimit dhe veprimit të nacionalizmit shqiptar. Kjo i jep monografisë një vlerë të shtuar në këtë drejtim.
- Një aspekt tjetër thelbësor dhe i merituar i kësaj monografie është se nacionalizmi shqiptar është analizuar në mënyrë krahasuese në raport me nacionalizmat e vendeve fqinje ballkanike. Këto analiza shquhen për karakterin origjinal dhe për seriozitetin e argumentimit shkencor.
- Nacionalizmi është parë edhe në raport me institucionet politike dhe jopolitike të shoqërisë shqiptare. Autori në mënyrë të qartë dhe bindëse ka zbuluar lidhjet, ndërvartësitë dhe ndikimet reciproke midis nacionalizmit shqiptar nga njëra anë dhe institucioneve të tjera, si partitë e grupimet e fshehta politike, organet përfaqësuese të qeverisë, ideologjitë politike prezente në Shqipëri. Ai ka paraqitur marrëdhëniet e tij me shtresat sociale të popullsisë shqiptare, raportin e nacionalizmit shqiptar me institucionet fetare, me minoritetet, si dhe me institucionet arsimore e kulturore etj.
- Mbështetur në sugjerimet tona dhe të kolegëve të tjerë, monografia ka pësuar një përmirësim të ndjeshëm në strukturë dhe tashmë

punimi ka një strukturë të mirë e të drejtë, të ndërtuar mbi një bazë logjike. Është për të vlerësuar se autori ka marrë në konsideratë kërkesën tonë për zgjerimin e kërkimeve në burimet arkivore dokumentare të huaja, veçanërisht atyre britanike, të cilat e kanë pasuruar më shumë mendimin e tij. Gjithashtu, në punim është thelluar analiza e fakteve dhe e dukurive të nacionalizmit shqiptar, duke marrë në konsideratë edhe argumentet që vijnë nga këto burime për nacionalizmin shqiptar.

- Autori ka arritur të shmangë mbajtjen e një qëndrimi të tërhequr, në lidhje me analizimin dhe argumentimin e nacionalizmit shqiptar në momente të caktuara historike.
- Në përfundim, punimi iu nënshtua një procesi redaktimi për të shmangur çdo lloj përsëritjeje të frazave, me qëllim që mendimi i autorit në tekst të vinte në trajtë më të sintetizuar.

Marrë në tërësi, e vlerësoj këtë monografi si një ndër punimet shkencore më serioze që janë paraqitur para Këshillit Shkencor dhe mendoj se monografia e dr. Sali Kadrisë, duhet të kalojë në procedurën e botimit.

Beqir META